



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-02904-0224083/20, më 08-12-2020

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERESIMIN E APLIKACIONEVE PËR GRANTE EKONOMIKE

- I. MIRATOHET Vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për grante ekonomike.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Muhedin Nushi, Nënkryetar, kryesues;
 2. Genc Bashota, drejtor i DPSZHQ, anëtar;
 3. Gresa Deda, nëpunëse civile, anëtare;
 4. Visar Berisha, anëtar i jashtëm;
 5. Arben Polloshka, anëtar i jashtëm.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është përcaktimi i kriterëve, kontrollimi dhe vlerësimi i të gjitha aplikacioneve online, pastrimi i te dhënave e që nënkupton: *korrigjimin e numrit fiskal ose numrit të biznesit dhe korrigjimin e llogarive bankare*, vendosjen e kriterëve të caktuara nga grupi për zhvillim ekonomik si: *A është biznesi aktiv/pasiv dhe përcaktimi i madhësisë së biznesit që ka aplikuar dhe publikimin e listës përfundimtare të përfituesve.*
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

